




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës të dt. 26.10.2020, parashtruar nga subjekti në procedurë: "Ejona "sh.p.k. me seli në Pejë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 lidhur me nenin 3.1 dhe 7 pika (b) të Rregullave për , më datën 29.10.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. **Hedhet poshtë si e papranueshme respektivisht konsiderohet se nuk është parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim nga subjekti në procedurë :** " Ejona "sh.p.k. me seli në Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: " **Furnizimi dhe instalimi i ashensorit në qendrën e kulturës " Hasan Prishtina " prok. Nr. 644 – 20 – 4997 – 1-2-1 dhe Nr. i brendshëm : 644 – 20 – 059 – 121 për shkak të mungesës së dokumentacionit adekuat dhe të mosparaqitjes të asnjë pretendimi ankimorë të palës në prcedurë.**
2. **Vërtetohet si i bazuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit për Kontratë të dt 21.10.2020**

A r s y e t i m

A.K.(në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të Kërkesës së Njësisë Kërkuese ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull : **Furnizimi dhe instalimi i ashensorit në qendrën e kulturës " Hasan Prishtina "** prok. Nr. 644 – 20 – 4997 – 1-2-1 dhe Nr. i brendshëm : 644 – 20 – 059 – 121 .

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. (në tekstin e mëtejme Njoftimi i A.K.) është ngritur për publikim në Platformën Elektronike më dt. 21.10.2020, bazuar në dispozitat e nenit 40 të LPP-së .

O.E. „ Ejona „sh.p.k. si palë në këtë procedurë, (në tekstin e mëtejme Ankuesi) ka pretenduar se në Platformën Elektronike ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pran A.K. duke mos përdoruar fare Formularin e autorizuar për parashtrim të Kërkesës për Rishqyrtim dhe, në të njëjtën kohë duke mos paraqitur dhe / ose parashtruar asnjë pretendim ankimorë në dokumentin e ngritur.

A.K. fillimisht ka shqyrtuar afatshmërinë dhe pranueshmërinë e Kërkesës , A.K. ka konstatuar se Kërkesa e OE " Ejona "sh.p.k. është e papranueshme dhe e pathemelt, sepse Kërkesa nuk është parashtruar në formën dhe procedurën e rregullt ashtu sikurse e parashef neni 5 i Rregullave për paraqitje të Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, pasi që e njëjta nuk përmban përshkrim të specifikave të arsyeshme të aktivitetit të prokurimit, nuk ka përshkrim të rrethanave faktike që e përbëjnë dhe / ose prodhojnë shkeljen e pretenduar të dispozitave të LPP-së duke specifikuar dhe dispozitat që janë shkelur.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

K.R. nr. 059/2020 - datë 29/10/2020

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtoria për Prokurim Publik


Amir Haradinaj, ZPP